



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) - NR. 12/2022 PËR REGJISTRIMIN, FUNKSIONIMIN DHE ÇREGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE¹

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) - NO. 12/2022 ON THE REGISTRATION, OPERATION AND DEREGISTRATION OF NON-GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS²

ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (VRK) - BR. 12/2022 O REGISTRACIJI, RADU I DEREGISTRACIJI NEVLADINIH ORGANIZACIJA³

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) - NR. 12/2022 për regjistrimin, funksionimin dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare, është aprovuar në mbledhjen e 106 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 04/106, datë 09.11.2022.

² Administrative Instruction (GRK) No. 12/2022 on the registration, operation and deregistration of non-governmental organizations, was approved on the 106th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No.04./106 dated 09.11.2022.

³ Administrativno Uputstvo (VRK) Br. 12/2022 o registraciji, radu i deregistraciji nevladinih organizacija, usvojen je na 106 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.04/106, datum 09.11.2022.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 25 (7), 42 (2) dhe 46 të Ligjit Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (GZ, Nr. 11 / 24 prill 2019) dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, Nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK - NR.12/2022 PËR REGJISTRIMIN, FUNKSIONIMIN DHE ÇREGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave për regjistrimin, funksionimin dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Articles 25 (7), 42 (2) and 46 of Law no. 06/L-043 on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations (OG, No. 11/24 April 2019) and Article 19 of the Regulation No. 09/2011 of Rules and Procedure of the Government of the Republic of Kosovo (OG, No.15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) - NO.12/2022 ON THE REGISTRATION, OPERATION AND DEREGISTRATION OF NON-GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is to define the procedures for registration, operation and deregistration of non-governmental organizations in the Republic of Kosovo.</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>U skladu sa članom 93 (4) Ustava Republike Kosovo, članovima 25 (7), 42 (2) i 46 Zakona br. 06 / L-043 o slobodi udruživanja u nevladine organizacije (Službeni list, br. 11/24. April 2019.) i član 19. Pravilnika o radu Vlade Republike Kosovo br. 09/2011 (SL, br. 15, 12.09.2011),</p> <p>Donosi:</p> <p>ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (VRK) - BR. 12/2022 O REGISTRACIJI, RADU I DEREGISTRACIJI NEVLADINIH ORGANIZACIJA</p> <p>POGLACLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>Svrha ovog Administrativnog uputstva je da definiše procedure za registraciju, rad i deregistraciju nevladinih organizacija u Republici Kosovo.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Ky udhëzim administrativ zbatohet për personat juridikë të organizuar dhe regjistruar si organizata joqeveritare në Republikën e Kosovës, sipas Ligjit Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>This Administrative Instruction is applied to legal entities organized and registered as non-governmental organizations in the Republic of Kosovo, according to Law no. 06/L-043 on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo primenjuje se na pravna lica koja su organizovana i registrovana kao nevladine organizacije u Republici Kosovo, u skladu sa Zakonom br. 06 / L-043 o slobodi udruživanja u nevladine organizacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Ligji – nënkupton Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare;</p> <p>1.2. OJQ – nënkupton Organizatat Joqeveritare;</p> <p>1.3. Departamenti – nënkupton Departamentin për Organizata Joqeveritare;</p> <p>1.4. SEOJQ – nënkupton Sistemin Elektronik për Organizata Joqeveritare.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Terms used in this Administrative Instruction have the following meanings:</p> <p>1.1. The Law – means Law no. 06/L-043 on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations;</p> <p>1.2. NGO – means Non-Governmental Organization;</p> <p>1.3. The Department – means the Department for Non-Governmental;</p> <p>1.4. ESNGO – means Electronic System for Non-Governmental Organizations.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. Zakon - podrazumeva Zakonom br. 06 / L-043 o slobodi udruživanja u nevladine organizacije;</p> <p>1.2. NVO - podrazumeva Nvladina organizacija;</p> <p>1.3. Odeljenje - podrazumeva Odeljenje za nevladine organizacije;</p> <p>1.4. ESNVO - podrazumeva Elektronskim sistemom za nevladine organizacije.</p>

<p>2. Shprehjet, termet dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e përcaktuara në Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI II PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E OJQ-së</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Format e organizimit të organizatave joqeveritare</p> <p>1. Organizata Joqeveritare siç është përcaktuar në nenin 19 të Ligjit, mund të organizohet si:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Shoqatë;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. Fondacion;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. Institut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Akti themelues i OJQ-së</p> <p>1. Të gjitha OJQ-të e përcaktuara në nenin 4 të këtij Udhëzimi administrativ themelohen përmes aktit themelues, i cili duhet të</p>	<p>2. All terms and expressions used in this Instruction have the same meaning as the definitions given in Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II PROCEDURES FOR REGISTRATION OF NGO</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Forms of organization of non- governmental organizations</p> <p>1. Non-Governmental Organization as defined in Article 19 of the Law, may be organized as follows:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Association;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. Foundation;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. Institute.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Founding act of the NGO</p> <p>1. All NGOs specified within Article 4 of this Administrative Instruction are established through the founding act, which</p>	<p>2. Svi izrazi i termini korišćeni u ovom uputstvu imaju isto značenje kao i definicije date Zakonom o slobodi udruživanja u nevladine organizacije.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II POSTUPCI ZA REGISTRACIJU NVO</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Oblici organizacije nevladinih organizacija</p> <p>1. Nevladina organizacija, kako je definisano u članu 19. Zakona, može biti organizovana na sledeći način :</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Udruženje;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. Fondacija;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. Institut.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Osnivački akt NVO</p> <p>1. Svi NVO-i utvrđeni u članu 4. ovog Administrativnog Uputstva osnivaju se</p>
--	--	---

<p>përmbajë të dhënat e përcaktuara në nenin 15 të Ligjit.</p> <p>2. Për secilën formë të organizimit të OJQ-së, palët e interesuara për themelimin e OJQ-së, mund të përdorin modelin e aktit themelues, sipas shtojcave të këtij Udhëzimi Administrativ, të cilat janë:</p> <p>2.1. Shtojca Nr. 1 - Modeli i aktit themelues për shoqatë;</p> <p>2.2. Shtojca Nr. 2 - Modeli i aktit themelues për fondacion;</p> <p>2.3. Shtojca Nr. 3 - Modeli i aktit themelues për institutit.</p> <p>3. Departamenti për Organizata Joqeveritare pranon edhe modele të tjera të aktit themelues të OJQ-së, përderisa të njëjtat përmbajnë të dhënat e përcaktuara me nenin 15 të Ligjit, si dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>must contain the data set out in Article 15 of the Law.</p> <p>2. For each form of organization, the interested parties for the establishment of the NGO, can use the model of the founding act, according to the following annexes of this Administrative Instruction:</p> <p>2.1. Annex No. 1 - Model of the founding act for the association;</p> <p>2.2. Annex No. 2 - Model of the founding act for the foundation;</p> <p>2.3. Annex No. 3 - Model of the founding act for the institute.</p> <p>3. The Department for Non-Governmental Organizations accepts other forms of the founding act of the NGO, as long as they contain the data specified in Article 15 of the Law, and are not contrary to applicable law.</p>	<p>osnivačkim aktom, koji mora sadržavati podatke utvrđene članom 15. Zakona.</p> <p>2. Za svaki oblik organizacije, zainteresovane strane za osnivanje NVO-a mogu koristiti model osnivačkog akta, prema sledećim aneksima na kraju ovog Administrativnog uputstva:</p> <p>2.1. Aneks br. 1 - Model osnivačkog akta za udruženje;</p> <p>2.2. Prilog br. 2 - Model osnivačkog akta za fondaciju;</p> <p>2.3. Aneks br. 3 - Model osnivačkog akta instituta.</p> <p>3. Odeljenje za nevladine organizacije prihvata i druge modele osnivačkog akta NVO, pod uslovom da sadrže podatke navedene u članu 15. Zakona i da nisu u suprotnosti sa važećim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Statuti i OJQ-së</p> <p>1. Rregullat e hollësishme të organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së OJQ-së, përcaktohen në Statutin e saj, i cili përmban të dhënat e përcaktuara me nenin 20 të Ligjit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Statute of the NGO</p> <p>1. The detailed rules of organization, operation and activity of the NGO are defined in its Statute, which shall contain the data defined in Article 20 of the Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Statut NVO-a</p> <p>1. Detaljna pravila organizacije, rada i delovanja NVO-a definisana su njenim Statutom, koji sadrži podatke definisane članom 20. Zakona.</p>

<p>2. Për secilën formë të organizimit, palët e interesuara për themelimin e OJQ-së, mund të përdorin modelin e Statutit, sipas shtojcave në fund të këtij Udhëzimi Administrativ, të cilat janë:</p> <p>2.1. Shtojca Nr. 4- Modeli i Statutit të shoqatës;</p> <p>2.2. Shtojca Nr. 5- Modeli i Statutit të fondacionit;</p> <p>2.3. Shtojca Nr. 6- Modeli i Statutit të institutit.</p> <p>3. Departamenti pranon edhe modele të tjera të Statutit të OJQ-së, përderisa të njëjtat përmbajnë të dhënat e përcaktuara me nenin 20 të Ligjit, si dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Kërkesa për regjistrimin e OJQ-së</p> <p>1. Në mënyrë që një OJQ të veprojë si person juridik në Kosovë, duhet të paraqitet kërkesa për regjistrim në Departament.</p> <p>2. Kërkesa për regjistrimin e OJQ-së, dorëzohet në mënyrë elektronike në</p>	<p>2. For each form of organization, interested parties for the establishment of the NGO, can use the model of the Statute, according to the annexes at the end of this Administrative Instruction, which are as follows:</p> <p>2.1. Annex No. 4- Model of Statute of the association;</p> <p>2.2. Annex No. 5- Model of Statute of the foundation;</p> <p>2.3. Annex No. 6- Model of Statute of the institute.</p> <p>3. The Department also accepts other models of the Statute of the NGO, as long as the same contains the data specified in Article 20 of the Law, and is not contrary to applicable law.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Application for registration of the NGO</p> <p>1. In order for an NGO to operate as a legal entity in Kosovo, an application for registration with the Department must be submitted.</p> <p>2. The application for registration of an NGO is submitted electronically to the</p>	<p>2. Za svaki oblik organizacije, zainteresovane strane za osnivanje NVO mogu koristiti model Statuta, prema aneksima na kraju ovog uputstva, koji su kako sledi:</p> <p>2.1. Aneks br. 4- Model statuta udruženja;</p> <p>2.2. Aneks br. 5- Model statuta fondacije;</p> <p>2.3. Dodatak br. 6- Model statuta instituta.</p> <p>3. Odeljenje prihvata i druge modele statuta NVO, sve dok isti sadrži podatke navedene u članu 20. Zakona i nije u suprotnosti sa važećim zakonom .</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Prijava za registraciju NVO-a</p> <p>1. Da bi NVO mogla da funkcioniše kao pravno lice na Kosovu, mora se podneti prijava za registraciju u Odeljenju .</p> <p>2. Ovlašćeni predstavnik za osnivanje NVO-a prijavu za registraciju NVO-a</p>
---	---	--

<p>Departament, nga përfaqësuesi i autorizuar për themelimin e OJQ-së, nëpërmjet plotësimit të Shtojcës Nr.7 - Kërkesa për regjistrim, të bashkëngjitur me këtë Udhëzim Administrativ.</p> <p>3. Kërkesa për regjistrim përmban të dhënat si në vijim:</p> <p>3.1. emrin zyrtar të OJQ-së;</p> <p>3.2.shkurtesën zyrtare të OJQ-së, nëse ka;</p> <p>3.3.informatën lidhur me formën e organizimit të OJQ-së;</p> <p>3.4.emrin mbiemrin, adresën dhe informatat kontaktuese të përfaqësuesit të autorizuar për themelimin e OJQ-së;</p> <p>3.5.adresën dhe të dhënat tjera kontaktuese të OJQ-së.</p> <p>4. Kërkesa për regjistrim të OJQ-së dërgohet së bashku me dokumentet vijuese:</p> <p>4.1. aktin e themelimit të nënshkruar nga secili themelues. Në rastet kur themelues janë personat juridik, akti themelues</p>	<p>Department, by the authorized representative for the establishment of the NGO, by completing Annex No. 7 - Application for registration, attached to this Administrative Instruction.</p> <p>3. The application for registration contains the following data:</p> <p>3.1. the official name of the NGO;</p> <p>3.2. the official abbreviation of the NGO, if any;</p> <p>3.3. information on the form of organization of the NGO;</p> <p>3.4. the name, address and contact information of the representative authorized to establish the NGO;</p> <p>3.5. address and other contact details of the NGO.</p> <p>4. The application for registration of the NGO shall be sent together with the following documents:</p> <p>4.1. founding act signed by each founder. In cases when the founders are legal entities, the founding act shall be</p>	<p>podnosi elektronskim putem Odeljenju popunjavanjem Aneksa br. 7 - Zahtev za registraciju, koji je priložen ovom Administrativnog Uputstvu.</p> <p>3. Prijava za registraciju sadrži sledeće podatke:</p> <p>3.1. zvanični naziv NVO-a;</p> <p>3.2. zvanična skraćenica NVO-a, ako postoji;</p> <p>3.3. informacije o obliku organizacije NVO;</p> <p>3.4. ime, adresa i kontakt podaci ovlašćenog predstavnika za osnivanje NVO;</p> <p>3.5. adresa i drugi kontakt podaci nevladine organizacije.</p> <p>4. Zahtev za registraciju NVO-a šalje se zajedno sa sledećim dokumentima:</p> <p>4.1. osnivački akt koji potpisuje svaki osnivač. U slučaju kada su osnivači pravna lica, osnivački akt potpisuje ovlašćeni predstavnik pravnog lica;</p>
--	--	--

<p>nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik;</p> <p>4.2. statutin e miratuar në mbledhjen themeluese të OJQ-së;</p> <p>4.3. kopjen e letërnjoftimit të themeluesve dhe përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së;</p> <p>4.4. certifikatën e regjistrimit, apo dokumentin tjetër të barasvlershëm, për personat juridik;</p> <p>4.5. Vendimi për caktim të përfaqësuesit juridik për personin juridik përkatës, në rastet kur themelues janë personat juridik;</p> <p>4.6. vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se personi juridik nuk ka obligime tatimore.</p>	<p>signed by the authorized representative of the legal entity;</p> <p>4.2. Statute approved at the founding meeting of the NGO;</p> <p>4.3. copy of the identity card of the founders and the authorized representative of the NGO;</p> <p>4.4. the certificate of registration, or other equivalent document, for legal entities;</p> <p>4.5. The decision to appoint a legal representative for the relevant legal entity, in cases where the founders are legal entities; and</p> <p>4.6. the certificate from the Tax Administration of Kosovo that proves that the legal entity has no tax obligations.</p>	<p>4.2. Statut usvojen na osnivačkom sastanku NVO;</p> <p>4.3. kopija lične karte osnivača i ovlašćenog predstavnika NVO;</p> <p>4.4. potvrda o registraciji ili drugi ekvivalentni dokument, za pravna lica;</p> <p>4.5. Odluka o imenovanju zakonskog zastupnika za odgovarajuće pravno lice, u slučajevima kada su osnivači pravna lica; kao i</p> <p>4.6. potvrda Poreske uprave Kosova koja dokazuje da pravno lice nema poreske obaveze.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p>Kërkesa për regjistrimin e degës së OJQ-së së vendit të huaj apo ndërkombëtare</p> <p>1. Dega e OJQ-së së e vendit të huaj ose ndërkombëtare, për t'u regjistruar në Republikën e Kosovës, e dërgon në mënyrë elektronike kërkesën për regjistrim pranë</p>	<p style="text-align: center;">Article 8</p> <p>Application for registration of a foreign or international NGO branch</p> <p>1. Foreign or international NGO branch, in order to be registered in the Republic of Kosovo, shall send the application for registration, electronically, to the Ministry in</p>	<p style="text-align: center;">Član 8</p> <p>Zahtev za registraciju inostranog ili međunarodnog ogranka NVO-a</p> <p>1. Ogranak strane ili međunarodne NVO, radi registracije u Republici Kosovo, elektronskim putem će poslati zahtev za registraciju pri nadležnom ministarstvu za</p>

<p>ministrisë përgjegjëse për administratë publike, së bashku me dokumentet e përcaktuara në nenin 24 të Ligjit.</p> <p>2. Degët e OJQ-ve të vendit të huaj ose ndërkombëtare, plotësojnë Shtojcën Nr. 8 - Kërkesa për regjistrim e degës së OJQ-së së vendit të huaj apo ndërkombëtare.</p> <p>3. Të gjitha dokumentet e degës së OJQ-së së huaj apo ndërkombëtare, dorëzohen të përkthyer nga përkthyesi i certifikuar, në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, sipas ligjit përkatës për përdorimin e gjuhëve.</p>	<p>charge of public administration, together with the documents defined in Article 24 of the Law.</p> <p>2. Foreign or international NGO branches shall complete Annex no. 8 - Application for registration of a foreign or international NGO branch.</p> <p>3. All documents of a foreign or international NGO branch shall be submitted translated by a certified translator, in one of the official languages in the Republic of Kosovo, according to the relevant law on the use of languages.</p>	<p>javnu upravu, zajedno sa dokumentima definisanim u članu 24. Zakona.</p> <p>2. Ogranci stranih ili međunarodnih NVO-a NVO, popunjavaju Aneks br. 8-Prijava za registraciju ogranka strane ili međunarodne NVO.</p> <p>3. Svi dokumenti ogranka strane ili međunarodne nevladine organizacije moraju biti prevedeni od strane ovlašćenog prevodioca, na jedan od službenih jezika u Republici Kosovo, u skladu sa relevantnim zakonom o upotrebi jezika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim të OJQ-së</p> <p>1. Departamenti shqyrton kërkesën për regjistrim të OJQ-së mbi parimin e prezumimit të ligshmërisë, sipas nenit 7 të Ligjit.</p> <p>2. Departamenti shqyrton kërkesën në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të kërkesës.</p> <p>3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për regjistrim të OJQ-së, Departamenti verifikon nëse:</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Review of the application for registration of the NGO</p> <p>1. The Department reviews the application for registration of an NGO on the principle of presumption of legality, according to Article 7 of the Law.</p> <p>3. The Department reviews the request within thirty (30) days from the date of receipt of the request.</p> <p>3. During the review of the application for registration of the NGO, the Department verifies whether:</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Pregled prijave za registraciju NVO</p> <p>1. Odeljenje razmatra prijavu za registraciju NVO na principu pretpostavke zakonitosti, u skladu sa članom 7. zakona .</p> <p>2. Odeljenje razmatra prijavu u roku od trideset (30) dana od dana prijema prijave .</p> <p>3. Tokom razmatranja prijava za registraciju NVO-a, Odeljenje proverava da li :</p>

<p>3.1. Akti Themelues i OJQ-së është në përputhje me nenin 15 të Ligjit;</p> <p>3.2. Kërkesat për formën e organizimit të OJQ-së, janë në përputhje me nenin 16 (për shoqatë), nenin 17 (për fondacion) dhe nenin 18 (për institut) të Ligjit;</p> <p>3.3. Statuti i përmban të dhënat e kërkuara në paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 20 të Ligjit, si dhe është në përputhje me kërkesat e nenit 12 për parimin jo-për-përfitim, nenit 31 për udhëheqje të brendshme, nenit 32 për parandalim të konfliktit të interesit, nenit 33 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nenit 34 për ndalimin e përkrahjes së fushatave politike, nenit 35 për pasurinë dhe mjetet e OJQ-së, nenit 36 për transaksionet në emër të OJQ-së, si dhe nenit 41 të Ligjit, për shuarjen e OJQ-së dhe pasurinë e mbetur.</p> <p>4. Në rastet kur Departamenti konsideron se informatat e ofruara përmes kërkesës për regjistrim, nuk janë të qarta ose dokumentacioni i dorëzuar nuk është i kompletuar, mund të kërkojë informacione, dokumente plotësuese apo sqarim me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së.</p>	<p>3.1. The Founding Act of the NGO is in accordance with Article 15 of the Law;</p> <p>3.2. The requirements for the form of organization of the NGO are in accordance with Article 16 (for association), Article 17 (for foundation) and Article 18 (for institute) of the Law;</p> <p>3.3. The Statute contains the data required in paragraphs 3, 4, 5 and 6 of Article 20 of the Law, and is in accordance with the requirements of Article 12 for the principle of non-profit, Article 31 for internal management, Article 32 for prevention of conflict of interest, Article 33 on dispute resolution, Article 34 on prohibition of support for political campaigns, Article 35 on NGO property and assets, Article 36 on transactions on behalf of an NGO, and Article 41 of Law on Extinction of NGOs and remaining property.</p> <p>4. In cases where the Department considers that the information provided through the registration request is not clear or the submitted documentation is not complete, it may request additional information, documents or written clarification from the authorized representative of the NGO.</p>	<p>3.1. je Osnivački akt NVO-a u skladu sa članom 15. Zakona ;</p> <p>3.2. su zahtevi za oblikom organizacije NVO-a u skladu sa članom 16. (za udruženje), članom 17. (za fondaciju) i članom 18. (za institut) zakona ;</p> <p>3.3. Statut sadrži podatke potrebne u paragrafima 3, 4, 5 i 6 člana 20 Zakona i u skladu je sa zahtevima člana 12 za načelo neprofitnosti, člana 31 za interno upravljanje, člana 32 za prevenciju sukoba interesa, člana 33 o rešavanju sporova, člana 34 o zabrani podrške političkim kampanjama, člana 35 o imovini i sredstvima NVO-a, člana 36 o transakcijama u ime NVO-a i člana 41 Zakona o razrešavanju NVO-a i preostaloj imovini.</p> <p>4. U slučajevima kada Odeljenje smatra da informacije koje su date u zahtevu za registraciju nisu jasne ili dostavljena dokumentacija nije potpuna, može zahtevati dodatne informacije, dokumenta ili pismeno pojašnjenje od ovlašćenog predstavnika NVO.</p>
--	---	---

<p>5. Afati nga paragrafi 2 i këtij neni, ndalet së rrjedhuri nga data e paraqitjes së kërkesës për kompletim të dokumentacionit.</p> <p>6. Me kërkesën e Departamentit për kompletim të dokumentacionit, përfaqësuesi i autorizuar obligohet që të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës nga Departamenti.</p> <p>7. Pas kompletimit dhe dërgimit të dokumentacionit, brenda afatit të mbetur sipas paragrafit 2 të këtij neni, Departamenti merr vendim për regjistrim të OJQ-së.</p> <p>8. Departamenti mund të marrë vendim për refuzimin e kërkesës për regjistrim të OJQ-së, në përputhje me parimin e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, duke dhënë arsyet, bazën juridike dhe këshillën juridike, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit.</p> <p>9. Pala e interesuar për themelim të OJQ-së, e cila nuk pajtohet me vendimin e Departamentit, ka të drejtë për të kundërshtuar ose kërkuar rishikimin e vendimeve, veprimeve apo mosveprimeve të Departamentit dhe institucioneve publike, duke përfshirë edhe të drejtën për të</p>	<p>5. The deadline from paragraph 2 of this article, stops from the date of submission of the request for completion of documentation.</p> <p>6. Upon the request of the Department for completion of the documentation, the authorized representative is obliged to respond within fifteen (15) days, from the day of receipt of the request by the Department.</p> <p>7. After completing and submitting the documentation, within the remaining deadline according to paragraph 2 of this article, the Department makes a decision to register the NGO.</p> <p>8. The Department may decide to reject the application for registration of an NGO, in accordance with the principle of necessity and proportionality, providing the reasons, legal basis and legal advice, as defined in Article 26 of the Law.</p> <p>9. An interested party to the establishment of an NGO that does not agree with the decision of the Department has the right to object or request a review of the decisions, actions or omissions of the Department and public institutions, including the right to sue the court competent for administrative matters,</p>	<p>5. Rok iz stava 2. ovog člana prestaje od datuma podnošenja zahteva za kompletiranje dokumentacije .</p> <p>6. Na zahtev Odeljenja za kompletiranje dokumentacije, ovlašćeni predstavnik je dužan da odgovori u roku od petnaest (15) dana, od dana kada od Odeljenja primi zahtev.</p> <p>7. Nakon kompletiranja i podnošenja dokumentacije, u preostalom roku prema stavu 2. ovog člana, Odeljenje donosi odluku o registraciji NVO .</p> <p>8. Odeljenje može odlučiti da odbije zahtev za registraciju NVO-a, u skladu sa načelom nužnosti i proporcionalnosti, navodeći razloge, pravnu osnovu i pravne savete, kako je definisano u članu 26. zakona.</p> <p>9. Zainteresovana strana u osnivanju nevladine organizacije koja se ne slaže sa odlukom Odeljenja ima pravo prigovora ili zahteva reviziju odluka, radnji ili propusta Odeljenja i javnih institucija, uključujući pravo tužbe na sudu nadležnim za upravne stvari, u roku od trideset (30) dana, u skladu</p>
---	---	--

<p>parashtruar padi në gjykatën kompetente për çështjet administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, në pajtim me ligjin përkatës mbi procedurën e përgjithshme administrative.</p> <p>10. Pas vendimit për regjistrim, Departamenti e përfshin OJQ-në në Regjistrin publik të OJQ-ve.</p> <p>11. Pas regjistrimit, OJQ-ja merr statusin e personit juridik dhe vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>within a period of thirty (30) days, in accordance with the relevant Law on General Administrative Procedure.</p> <p>10. Following the registration decision, the Department includes the NGO in the Public Register of NGOs.</p> <p>11. After registration, the NGO obtains the status of a legal entity and acts in accordance with applicable law.</p>	<p>sa odgovarajućim zakonom o opštem upravnom postupku.</p> <p>10. Nakon odluke o registraciji, Odeljenje uključuje NVO u javni registar NVO-ova.</p> <p>11. Nakon registracije, NVO stiče status pravnog lica i deluje u skladu sa važećim zakonom .</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Certifikata e regjistrimit të OJQ-së</p> <p>1. Pas regjistrimit në Regjistrin Publik të OJQ-ve, brenda shtatë (7) dite, Departamenti lëshon certifikatë të regjistrimit për OJQ-në.</p> <p>2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së përfshin informatat si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. emrin e plotë të organizatës;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. shkurtesën, nëse ka;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. numrin dhe datën e regjistrimit;</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Certificate of registration of NGO</p> <p>1. After registration in the Public Register of NGOs, within seven (7) days, the Department issues a registration certificate for the NGO.</p> <p>2. The NGO registration certificate includes the following information:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. the full name of the organization;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. the abbreviation, if any;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. registration number and date;</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Potvrda o registraciji NVO-a</p> <p>1. Nakon registracije u Javnom registru NVO-ova, u roku od sedam (7) dana, Odeljenje izdaje potvrdu o registraciji NVO-a .</p> <p>2. Potvrda o registraciji NVO-a uključuje sledeće informacije :</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. pun naziv organizacije;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. skraćenica, ako postoji;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. registracioni broj i datum;</p>

<p>2.4. numrin fiskal;</p> <p>2.5. datën e skadimit të afatit fillestar të certifikatës (për OJQ-të e regjistruara si fondacione).</p> <p>3. Për OJQ-të e regjistruara si fondacione, certifikata e regjistrimit të OJQ-së lëshohet me afat fillestar prej gjashtë (6) muajsh nga data e lëshimit.</p> <p>4. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së i dorëzohet përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së.</p>	<p>2.4. fiscal number;</p> <p>2.5. the expiration date of the certificate initial term (for NGOs registered as foundations).</p> <p>3. For NGOs registered as foundations, the NGO registration certificate is issued with an initial term of six (6) months from the date of issue.</p> <p>4. The NGO registration certificate is submitted to the authorized representative of the NGO.</p>	<p>2.4. fiskalni broj;</p> <p>2.5. datum isteka početnog roka potvrde (za NVO-e koje su registrovane kao fondacije).</p> <p>3. Za NVO-e koje su registrovane kao fondacije, potvrda o registraciji NVO-a se izdaje sa početnim rokom od šest (6) meseci od datuma izdavanja.</p> <p>4. Potvrda o registraciji NVO-a dostavlja se ovlašćenom predstavniku NVO-a.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Dëshmia e kapitalit fillestar të fondacioneve</p> <p>1. Jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së lëshimit të certifikatës së regjistrimit të OJQ-së, OJQ-të e regjistruara si fondacione dorëzojnë në Departament dëshminë nga një bankë komerciale e licensuar në Republikën e Kosovës që shuma e plotë e kapitalit fillestar është depozituar në llogarinë bankare në emër të organizatës, apo dëshminë e noterizuar që asetet e paraqitura si kapital fillestar janë transferuar në pronësi të fondacionit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Proof of initial capital of foundations</p> <p>1. No later than six (6) months after the date of issuance of the NGO registration certificate, the NGOs registered as foundations shall submit to the Department the proof from a commercial bank licensed in the Republic of Kosovo that the full amount of the initial capital has been deposited in the bank account on behalf of the organization, or notarized proof that the assets presented as initial capital have been transferred to the ownership of the foundation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Dokaz o početnom kapitalu fondacija</p> <p>1. Ne kasnije od šest (6) meseci od datuma izdavanja potvrde o registraciji NVO-a, NVO-i koji su registrovani kao fondacije dostavljaju Odeljenju uverenje iz jedne komercijalne banke koja je licencirana u Republici Kosovo, da je kompletan iznos početnog kapitala deponovan na bankarski račun u ime organizacije, ili overeno uverenje da imovina koja je predstavljena kao početni kapital je prenetu u vlasništvo fondacije.</p>

<p>2. Pas pranimit të dëshmisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda shtatë (7) dite, Departamenti lëshon certifikatën e përhershme të regjistrimit për OJQ-në e regjistruar si fondacion.</p> <p>3. Tridhjetë (30) ditë para kalimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, Departamenti njofton me shkrim OJQ-në e regjistruar si fondacion e cila nuk e ka dorëzuar dëshminë sipas paragrafit 1 të këtij neni, dhe kërkon përmbushjen e këtij obligimi ligjor sipas afatit përkatës.</p> <p>4. Në rast se OJQ-ja e regjistruar si fondacion dështon të dorëzojë dëshminë pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Departamenti merr vendim për moslejimin e certifikatës së përhershme dhe largimin e OJQ-së nga Regjistri Publik i OJQ-ve, dhe për këtë e njofton me shkrim OJQ-në, si dhe autoritetet tatimore e doganore.</p>	<p>2. After receiving the proof according to paragraph 1 of this article, within seven (7) days, the Department shall issue the permanent registration certificate for the NGO registered as a foundation.</p> <p>3. Thirty (30) days before the expiration of the deadline specified in paragraph 1 of this Article, the Department shall notify in writing the NGO registered as a foundation that has not submitted the proof according to paragraph 1 of this Article, and shall require the fulfillment of this legal obligation according to the relevant deadline.</p> <p>4. In case the NGO registered as a foundation fails to submit the proof after the deadline specified in paragraph 1 of this Article, the Department shall decide not to allow the permanent certificate and to remove the NGO from NGOs Public Register, and shall notify the NGO in writing in this regard, as well as the tax and customs authorities.</p>	<p>2. Po prijemu uverenja iz stava 1. ovog člana, u roku od sedam (7) dana, Odeljenje izdaje trajnu potvrdu o registraciji za NVO koja je registrovana kao fondacija.</p> <p>3. Trideset (30) dana pre isteka roka iz stava 1. ovog člana, Odeljenje pismeno obaveštava NVO koja je registrovana kao fondacija, koja nije dostavila uverenje iz stava 1. ovog člana, i traži da ispuni ovu zakonsku obavezu u skladu sa odgovarajućim rokom.</p> <p>4. U slučaju da NVO koja je registrovana kao fondacija ne uspe da dostavi uverenje po isteku roka utvrđenog u stavu 1. ovog člana, Odeljenje donosi odluku o nedozvoljavanju trajne potvrde i uklanjanju NVO-a iz Javnog registra NVO-a, i o tome pismenim putem obaveštava NVO, kao i poreske i carinske organe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Regjistri publik i OJQ-ve</p> <p>1. Departamenti mban dhe përditëson Regjistrin e OJQ-ve me të dhënat e përcaktuara në nenin 30 të Ligjit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Public register of NGOs</p> <p>1. The Department maintains and updates the Register of NGOs with the data specified in Article 30 of the Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Javni registar NVO-ova</p> <p>1. Odeljenje vodi i ažurira Registar NVO sa podacima navedenim u članu 30. Zakona .</p>

<p>2. Departamenti publikon regjistrin me të dhënat si më poshtë:</p> <p>2.1. emrin e plotë, shkurtesën;</p> <p>2.2. formën organizative (shoqatë, fondacion, institut);</p> <p>2.3. informatën nëse OJQ është OJQ e vendit, e vendit të huaj apo ndërkombëtare;</p> <p>2.4. qëllimin dhe fushë-veprimtarinë;</p> <p>2.5. statusin për përfitim publik dhe numrin e certifikatës për Status për Përfitim Publik, nëse ka një të tillë.</p> <p>3. Departamenti përditëson regjistrin publik të OJQ-ve bazuar në të dhënat e ofruara me rastin e regjistrimit, si dhe njoftimet mbi ndryshimin e të dhënave të OJQ-ve.</p> <p>4. Informatat për ndryshimet në të dhëna, dërgohen në mënyrë elektronike në Departament, nëpërmjet paraqitjes të të gjitha ndryshimeve me dëshmitë e nevojshme për ndryshimet e bëra. Dispozitat e përcaktuara për regjistrimin e OJQ-ve, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për ndryshimet e të dhënave.</p>	<p>2. The Department publishes the register with the following data:</p> <p>2.1. full name, abbreviation;</p> <p>2.2. organizational form (association, foundation, institute);</p> <p>2.3. information whether the NGO is a domestic, foreign or international;</p> <p>2.4 purpose and field of activity;</p> <p>2.5. public benefit status and public benefit status certificate number, if any;</p> <p>3. The Department updates the public register of NGOs based on the data provided during the registration, as well as the notifications on the change of the data of the NGOs.</p> <p>4. Information on changes in data is sent electronically to the Department, through the submission of all changes with the necessary evidence for the changes made. The provisions set out for the registration of NGOs apply mutatis mutandis to changes in data.</p>	<p>2. Odeljenje objavljuje registar sa sledećim podacima :</p> <p>2.1. pun naziv, skraćenica;</p> <p>2.2. organizaciona forma (udruženje, fondacija, institut);</p> <p>2.3. informaciju da li je NVO domaća, strana ili međunarodna NVO;</p> <p>2.4. svrha i područje delovanja;</p> <p>2.5. status za javnu korist i broj potvrde o Statusu za javnu korist, ako postoji;</p> <p>3. Odeljenje ažurira javni registar NVO-ova na osnovu podataka pruženih prilikom registracije, kao i obaveštenja o promeni podataka NVO .</p> <p>4. Informacije o promenama podataka šalju se elektronskim putem Odeljenju, podnošenjem svih promena sa potrebnim dokazima za izvršene promene. Odredbe utvrđene za registraciju NVO-a primenjuju se mutatis mutandis na promene podataka.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 13 Informimi i Departamentit për ndryshimet në OJQ</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Informing the Department about changes in NGOs</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Obaveštavanje Odeljenja o promenama u NVO</p>
<p>1. OJQ-ja e informon Departamentin brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga dita e ndryshimit, lidhur me çdo ndryshim që pësojnë të dhënat e përcaktuara me nenin 29 te Ligjit për OJQ.</p> <p>2. Ndryshimet që i pranon Departamenti mbahen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion të publikut, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Udhëzim, përveç rasteve kur ndryshimet nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>3. Përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së e informon në mënyrë elektronike Departamentin, për ndryshimet në të dhënat e OJQ-së sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëpërmjet plotësimit të Shtojcës nr.9- Njoftimi për ndryshimin e të dhënave të OJQ-së.</p> <p>4. Departamenti pranon kërkesën për ndryshim të të dhënave në kopje fizike, kur për shkaqe objektive kërkesa nuk mund të dërgohet në mënyrë elektronike.</p>	<p>1. The NGO shall inform the Department within thirty (30) days from the day of the change, regarding any change that undergoes the data specified in Article 29 of the Law on NGOs.</p> <p>2. Amendments accepted by the Department shall be kept, registered and made available to the public, in accordance with the provisions set forth in the Law and this Instruction, unless the changes are not in accordance with the requirements of Article 9 of this Administrative Instruction.</p> <p>3. The authorized representative of the NGO electronically informs the Department about the changes in the NGO data according to paragraph 1 of this article, by completing Annex no.9- Notification for the change of the NGO data.</p> <p>4. The department accepts the request for change of data in hard copy, when the request for objective reasons cannot be sent electronically.</p>	<p>1. NVO će obavestiti Odeljenje u roku od trideset (30) dana od dana promene, o bilo kojoj promeni koja podleže podacima navedenim u članu 29. Zakona o NVO .</p> <p>2. Izmene i dopune koje prihvati Odeljenje čuvaju se, evidentiraju i stavljaju na raspolaganje javnosti, u skladu sa odredbama zakona i ovog uputstva, osim ako promene nisu u skladu sa zahtevima člana 9. ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>3. Ovlašćeni predstavnik NVO-a elektronski obaveštava Odeljenje o promenama podataka NVO-a u skladu sa stavom 1. ovog člana, popunjavanjem Aneksa br.9- Obaveštenje o promeni podataka NVO-a.</p> <p>4. Odeljenje prihvata zahtev za promenu podataka u štampanom obliku, kada se zahtev iz objektivnih razloga ne može poslati elektronskim putem.</p>

**KAPITULLI III
STATUSI I PËRFITIMIT PUBLIK I
OJQ-së, RAPORTIMI FINANCIAR DHE
PEZULLIMI-REVOKIMI I TIJ**

**Neni 14
Statusi për Përfitim Publik**

1. Secila OJQ e regjistruar mund të paraqesë kërkesë për status të përfitimit publik, nëse është e organizuar dhe vepron për të ndërmarrë një apo më shumë aktivitete të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 37 të Ligjit.
2. Kërkesa për përfitim të statusit të përfitimit publik dorëzohet në mënyrë elektronike në Departament, nëpërmjet plotësimit të Shtojcës Nr.10- Kërkesë për njohje të statusit për përfitim publik.
3. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet me rastin e regjistrimit të OJQ së, ose me vonë.
4. Brenda tridhjetë (30) ditësh, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës nga paragrafi 1 të këtij neni, nëse dokumentet e regjistrimit dëshmojnë se qëllimet dhe veprimtaria e OJQ-së i plotësojnë kërkesat e nenit 37 të Ligjit, Departamenti nxjerrë vendim për

**CHAPTER III
PUBLIC BENEFIT STATUS OF THE
NGO, ITS FINANCIAL REPORTING
AND ITS SUSPENSION-
REVOCATION**

**Article 14
Public Benefit Status**

1. Any registered NGO may apply for public benefit status if it is organized and operates to undertake one or more of the activities set forth in paragraph 1 of Article 37 of the Law.
2. The application for public benefit status shall be submitted electronically to the Department, by completing Annex No. 10 - Application for recognition of public benefit status.
3. The application according to paragraph 1 of this Article can be made upon the registration of the NGO, or later.
4. Within thirty (30) days, after reviewing and evaluating the application mentioned in paragraph 1 of this Article, if the registration documents prove that the objectives and activity of the NGO meet the requirements of Article 37 of the Law, the Department

**POGLAVLJE III
JAVNO KORISNI STATUS NVO,
FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE I
OBUSTAVLJANJE-RASPUŠTANJE**

**Član 14
Javno korisni status**

1. Svaka registrovana nevladina organizacija može se prijaviti za status javne koristi ako je organizovana i radi na preduzimanju jedne ili više aktivnosti navedenih u stavu 1. člana 37. zakona .
2. Prijava za status javne koristi podnosi se Odeljenju elektronskim putem popunjavanjem Aneksa br. 10 - Zahtev za priznavanje statusa javne koristi.
3. Prijava prema stavu 1. ovog člana može se podneti nakon registracije NVO-a ili kasnije .
4. U roku od trideset (30) dana, nakon razmatranja i ocene zahteva navedenog u stavu 1. ovog člana, ako dokumenti o registraciji dokažu da ciljevi i aktivnosti NVO ispunjavaju uslove iz člana 37.

<p>lejimin apo refuzimin e statusit të përfitimit publik për OJQ-kërkuese.</p> <p>5. Në rast të vendimit për lejimin e statusit të përfitimit publik, brenda shtatë (7) dite, Departamenti lëshon për OJQ-në certifikatë për njohjen e statusit për përfitim publik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Raportimi financiar, pezullimi dhe revokimi i Statusit për Përfitim Publik</p> <p>1. OJQ-ja me status për përfitim publik, në pajtim me nenin 38 të Ligjit, dorëzon raport vjetor për veprimtarinë e saj në Republikën e Kosovës. Raporti vjetor për vitin paraprak kalendarik, i dorëzohet në mënyrë elektronike Departamentit, jo më vonë se 31 mars të vitit vijues, nëpërmjet plotësimit të Shtojcës Nr.11 Raporti vjetor.</p> <p>2. Pas kalimit të afatit për raportim, Departamenti njofton me shkrim OJQ-në me status për përfitim publik, e cila nuk e ka dorëzuar raportin vjetor sipas nenit 38 të Ligjit dhe kërkon përmbushjen e këtij obligimi ligjor brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit me shkrim.</p>	<p>shall issue a decision to grant or refuse the public benefit status for the applicant NGO.</p> <p>5. In the event of a decision to grant public benefit status, within seven (7) days, the Department shall issue a certificate to the NGO for recognition of public benefit status.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Financial reporting, suspension and revocation of Public Benefit Status</p> <p>1. An NGO with public benefit status, in accordance with Article 38 of the Law, shall submit an annual report on its activity in the Republic of Kosovo. The annual report for the previous calendar year shall be submitted electronically to the Department, no later than March 31 of the following year, by completing Annex No. 11 - Annual Report.</p> <p>2. After the deadline for reporting, the Department shall notify in writing the NGO with public benefit status, which has not submitted the annual report according to Article 38 of the Law and shall request the fulfilment of this legal obligation within thirty (30) days from the date of written notice.</p>	<p>zakona, Odeljenje će izdati odluku o dodeli ili odbijanju statusa javne koristi NVO.</p> <p>5. U slučaju odluke o dodeli statusa javne koristi, u roku od sedam (7) dana, Odeljenje će izdati potvrdu NVO-u za priznavanje statusa javne koristi .</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Finansijsko izveštavanje, suspenzija i opoziv statusa javne koristi</p> <p>1. NVO sa statusom javne koristi, u skladu sa članom 38. zakona, podnosi godišnji izveštaj o svojoj delatnosti u Republici Kosovo. Godišnji izveštaj za prethodnu kalendarsku godinu dostavlja se Odeljenju elektronskim putem, najkasnije do 31. marta naredne godine, popunjavanjem Aneksa br. 11 - Godišnji izveštaj.</p> <p>2. Nakon isteka roka za izveštavanje, Odeljenje će pismenim putem obavestiti NVO sa statusom javne koristi koja nije podnela godišnji izveštaj u skladu sa članom 38. Zakona i zatražiće ispunjenje ove zakonske obaveze u roku od trideset (30) dana od datuma pismenog obaveštenja.</p>
---	--	---

<p>3. Në rast se OJQ-ja me status për përfitim publik dështon të dorëzojë raportin e plotë edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Departamenti merr vendim për pezullimin e statusit për përfitim publik dhe e njofton me shkrim OJQ-në për pezullimin.</p> <p>4. Nëse OJQ-ja dështon të dorëzojë raportin brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit për pezullim, Departamenti merr vendim për revokimin e statusit për përfitim publik të OJQ-së.</p> <p>5. Departamenti publikon listën e OJQ-ve në regjistrin publik që gjendet në web faqen e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, të cilave u është revokuar statusi për përfitim publik, si dhe njofton me shkrim autoritetin tatimor dhe doganor.</p> <p>6. OJQ-ja të cilës i është revokuar statusi për përfitim publik, ka të drejtë të kërkojë përsëri të njëjtin status, pas kalimit të periudhës dy (2) vjeçare nga data e revokimit. Kërkesa për rinjohje të statusit për përfitim publik paraqitet në mënyrë elektronike në Departament, nëpërmjet plotësimit të Shtojcës Nr. 12- Kërkesa për rinjohje të statusit për përfitim publik.</p>	<p>3. In case the NGO with public benefit status fails to submit the full report even after the deadline specified in paragraph 2 of this Article, the Department shall make a decision to suspend the public benefit status and notify the NGO in writing of the suspension.</p> <p>4. If the NGO fails to submit the report within thirty (30) days from the date of the notice of suspension, the Department shall decide to revoke the NGO's public benefit status.</p> <p>5. The Department shall publish the list of NGOs in the public register, which can be found on the website of the Ministry in charge of public administration, whose public benefit status has been revoked, and notify in writing the tax and customs authority.</p> <p>6. The NGO, whose public benefit status has been revoked, is entitled to request the same status again, after the expiration of a period of two (2) years from the date of revocation. The request for re-recognition of public benefit status shall be submitted electronically to the Department, by completing Annex No. 12 - Application for re-recognition of public benefit status.</p>	<p>3. U slučaju da NVO sa statusom javne koristi ne dostavi potpuni izveštaj ni nakon roka navedenog u stavu 2. ovog člana, Odeljenje će doneti odluku o suspenziji statusa javne koristi i pismeno obavestiti NVO o suspenziji.</p> <p>4. Ako NVO ne podnese izveštaj u roku od trideset (30) dana od dana obaveštenja o suspenziji, Odeljenje će odlučiti da opozove status javne koristi NVO-a.</p> <p>5. Odeljenje će objaviti listu NVO-a u javni registar koji se nalazi na veb stranici nadležnog ministarstva za javnu upravu, kojima je ukinut status javne koristi i o tome pismeno obavestiti poresku i carinsku upravu .</p> <p>6. NVO, kojoj je ukinut status javne koristi, ima pravo ponovo zatražiti isti status, nakon isteka perioda od dve (2) godine od datuma opoziva. Zahtev za ponovno priznavanje statusa javne koristi podnosi se Odeljenju elektronskim putem popunjavanjem Aneksa br. 12 - Zahtev za ponovno priznavanje statusa javne koristi.</p>
---	---	--

